

**MARRËVESHJA**  
**NDËRMJET**  
**QEVERISË SË REPUBLIKËS SË KOSOVËS**  
**DHE**  
**QEVERISË SË REPUBLIKËS SË SLLOVENISË**  
**PËR BASHKËPUNIM POLICOR**

Qeveria e Republikës së Kosovës dhe Qeveria e Republikës së Sllovenisë ( në tekstin e mëtejshëm  
" Palët Kontraktuese" )

Duke u përpjekur për të kontribuar në zhvillimin e marrëdhënieve dypalëshe;

duke dashur të përforcojnë bashkëpunimin në luftën kundër të gjitha formave të krimit, veçanërisht krimit të organizuar, trafikimit të qenieve njerëzore dhe migrimit të paligjshëm, trafikimit të drogave të paligjshme dhe prekursorëve, terrorizmit dhe vepra të tjera penale dhe në shmangien e rrezikut dhe garantimin e sigurisë publike , rendit publik dhe veçanërisht sigurinë e trafikut ,

kanë rënë dakord si më poshtë:

### Neni 1

(1) Palët Kontraktuese në përputhje me legjislacionin e tyre nacional,do të bashkëpunojnë në përpjekjet e tyre për të luftuar krimin, veçanërisht krimin e organizuar, trafikimin e qenieve njerëzore dhe migrimin ilegal, trafikimin e drogave të paligjshme dhe prekursorëve, terrorizmit dhe për të parandaluar, zbuluar dhe hetuar vepra të tjera penale të karakterit ndërkombëtar.

(2) Palët Kontraktuese do të bashkëpunojnë sidomos në rastet kur kryhen veprat penale ose janë duke u përgatitur për të ndodhë, ose që kanë ndodhur, në territorin njëres prej Palëve Kontraktuese, ndërsa ka të dhëna që mundë te ekzistojnë vepra të ngjashme ose përgatitjet e tyre për të ndodhë, ose që kanë ndodhur, në territorin e Palës tjetër Kontraktuese.

### Neni 2

(1) Bashkëpunimi ndërmjet Palëve Kontraktuese do të bazohet në parimin e reciprocitetit dhe do të përfshijë shkëmbimin e informacionit dhe të dhënave të identifikimit të personave ", dhe masa të tjera në përputhje me qëllimin e kësaj Marrëveshjeje, duke respektuar legjislacionin nacional të palëve Kontraktuese dhe detyrimet e tyre ndërkombëtare.

(2) Për të zbatuar këtë Marrëveshje, Palët Kontraktuese mund të shkëmbejnë të dhënat personale në vijim, në përputhje me legjislacionin e tyre nacional:

a ) të dhënat personale të individëve që kanë marrë pjesë në kryerjen e veprës penale dhe individët në lidhje me kryerjen e veprës penale: mbiemrin, ish- mbiemrin, emrin e parë, emra të tjerë ( emërtimet, pseudonime), gjininë, datën dhe vendin e lindjes dhe te banimit, përkatësinë etnike të tanishëm dhe të mëparshëm, dhe të dhënat biometrike të një individi në përputhje me legjislacionin për dokumentet e udhëtimit ose ligjet apo aktet tjera ligjore nacionale;

b ) të dhëna për dokumentin që vërteton identitetin e individit në paragrafin a ) të këtij neni, d.m.th. një pasaportë ose dokument tjetër udhëtimi ( numri, data e lëshimit, autoriteti lëshues, vendi i lëshimit, periudhën e vlefshmërisë, zonë e vlefshmërisë );

c ) të dhënat duke iu referuar gjurmëve të gishtit apo pëllëmbës së individit të përfshirë në kryerjen e veprës penale, profilit të ADN-së ose mostre, përshkrimit personal, fotografi;

d ) të dhëna të tjera personale të mbledhura dhe të shkëmbyera nga Palët Kontraktuese të cilat bashkëpunojnë për qëllime të zbatimit të kësaj Marrëveshjeje.

3) Kërkesa mund t'i referohet edhe:

a) Identifikimit të pronarëve dhe përdoruesve të mjeteve motorike, anijeve dhe avionëve, si dhe informacionit në lidhje me personat të cilët kanë ikur nga vendi i ngjarjes së aksidenteve dhe nuk është arritur të sigurohet informacioni i nevojshëm në polici për personin e përfshirë në aksident. Në përgjigje të një kërkesë të paraqitur nga Pala Kontraktuese, Pala Kontraktuese kërkuese do të dërgojë të dhënat për mjetet motorike, anijet dhe avionët, dhe të dhënat për pronarët dhe përdoruesit e tyre, nëse këto janë të nevojshme me qëllim të identifikimit të pronarit / përdoruesit të automjetit ose mjetit të përdorur, apo të dhëna të automjeteve të nevojshme për zbatimin e kësaj Marrëveshjeje. Autoriteti kompetent i Palës Kontraktuese kërkuese mund të dërgojë një kërkesë autoritetit që të administrojë bazën e të dhënave të regjistrimit të automjeteve, anijeve dhe avionëve.

b) informacionit për patentë shoferët dhe dokumentet e regjistrimit të automjeteve dhe format e tyre mostër;

c) identifikimit të vendit të qëndrimit / vendbanimit, dhe të lejes së qëndrimit;

d) bashkëpunimi dhe shkëmbimi i informacionit për kontrollin e turmave në tubime publike, duke përfshirë edhe informacione lidhur me udhëtimin dhe strukturën e mbështetësve që ndjekin ngjarjen sportive;

e) informacionit në lidhje me origjinën e objekteve, p.sh. armët e zjarrit, municionit dhe eksplozivëve, pajisjeve eksplozive, automjeteve motorike, anijet dhe avionët, dhe artikujve kulturore.

(4) Palët Kontraktuese do të shkëmbejnë inteligjencën relevante kundër kalimit të paligjshëm të kufirit dhe kontrabandës me njerëz. Informacioni i shkëmbyer në këtë mënyrë do t'i referohet lëvizjeve të migracionit dhe të fushëveprimit dhe strukturës së tyre, si dhe destinacionet, rrugët e mundshme të migracionit dhe mjeteve të transportit të përdorura për kalim të paligjshëm të kufirit, si dhe mënyrën në të cilën trafikantët organizojnë aktivitetet e tyre. Inteligjenca dhe informacioni analitik për gjendjen aktuale të veprimit si dhe masat e destinuara që janë me rëndësi për Palën tjetër Kontraktuese do të shkëmbehen.

(5) Bashkëpunimi do të sigurojë mundësinë e dërgimit të zyrtarëve për të kryer detyrën te pala

tjetër kontraktuese dhe të përfshij shkëmbimin e eksperiencës mbi masat për parandalimin dhe luftimin e krimit, këmbimin e ekspertëve dhe ndarjen e informacionit për situatën e krimit dhe trendët në Palët Kontraktuese.

### Neni 3

(1) Autoritetet kompetente për bashkëpunimin e kësaj Marrëveshjeje do të jetë:

në Republikën e Kosovës: Ministria e Punëve të Brendshme e Republikës së Kosovës,  
Drejtoria e Përgjithshme e Policisë.,

në Republikën e Sllovenisë: Ministria e Punëve të Brendshme e Republikës së Sllovenisë,  
Drejtoria e Përgjithshme të Policisë;

dhe

(2) Kërkesat për të dhëna ose masa tjera sipas kësaj Marrëveshjeje do të shkëmbehen direkt nga Autoritetet kompetente përmes një kanali të sigurt komunikimi. Në mungesë të një kanali të sigurt komunikimi, një metodë e duhur për transferimin e të dhënave do të përdoren duke respektuar ndjeshmërinë e të dhënave. Në raste urgjente kërkesa verbale do të pranohet, por duhet të konfirmohet me shkrim menjëherë. Përgjigjja do të jepet vetëm pas pranimi të kërkesës me shkrim. Palët Kontraktuese duhet të sigurojnë qasje të sigurt për pajisjet e komunikimit që do të përdoren për qëllimin e lartpërmendur, të cilat u lejohen vetëm personave të autorizuar.

(3) Përveç nëse pajtohen ndryshe, autoritetet kompetente do të komunikojnë në gjuhën angleze.

(4) Informacioni i nevojshëm për komunikim, duke përfshirë adresat e pikave kontaktuese nga neni paraprak, do të shkëmbehen direkt nga Autoritetet kompetente.

### Neni 4

Duke pasur parasysh legjislacionin nacional të Palëve Kontraktuese dhe Konventën e Këshillit të Evropës për Mbrojtjen e Individëve në lidhje me Përpunimin Automatik të të Dhënave Personale e bërë në Strasburg më 28 janar 1981, dhe Rekomandimin nr. R ( 87 ) 15 i Komitetit të Ministrave të Këshillit të Evropës të Shteteve Anëtare që rregullon përdorimin e të dhënave personale në sektorin e policisë të 17 shtatorit 1987, e cila i gjithashtu referohet edhe në rastet kur të dhënat nuk janë të përpunuara automatikisht, kushtet e mëposhtme të mbrojtjes së të dhënave personale të shkëmbyera gjatë bashkëpunimit:

- a) Të dhënat personale mund të përpunohen vetëm nga Pala Kontraktuese pranuese për qëllime të shmangies së rrezikut dhe garantimin e sigurisë publike, rendin publik dhe veçanërisht sigurinë e trafikut si dhe për qëllime të luftimit të krimit të organizuar, trafikimit të qenieve njerëzore dhe migrimit ilegal, trafikimin e drogave të paligjshme dhe prekursorëve dhe terrorizmit, dhe parandalimin, zbulimin dhe ndjekjen e veprave të tjera penale me karakter ndërkombëtarë me kusht që masat mbrojtëse adekuate teknike janë vënë në vend për transmetimin e të dhënave personale dhe mbrojtjen e tyre.
- b) Nëse kërkohet nga Pala Kontraktuese ofruese, Pala Kontraktuese që ka pranuar do të raportojë për përdorimin e këtyre të dhënave dhe rezultateve të ndërlidhura.
- c) Të dhënat duhet të shkëmbehen vetëm ndërmjet autoriteteve kompetente të përcaktuara në nenin 3 të kësaj Marrëveshjeje. Shpërndarja e mëtejshme e të dhënave të organeve të tjera i nënshtrohet pëlqimit paraprak me shkrim të Palës Kontraktuese pranuese.
- d) Pala Kontraktuese ofruese do të siguroj se të dhënat e shkëmbyera janë të sakta. Në qoftë se kjo del se të dhënat janë të pasakta apo nuk duhet të ishin të komunikuar, Pala Kontraktuese pranuese do të njoftohet menjëherë. Pala Kontraktuese pranuese ose do të korrigjojë të dhënat ose do të bëjë asgjësimin e tyre.
- e) Në bazë të kërkesës, subjekti i të dhënave do të sigurojnë të gjitha të dhënat e kërkuara relevante dhe informacionin i përpunimit të tyre. Sigurimi i detajeve të të dhënave personale i nënshtrohet legjislacionit nacional të Palës Kontraktuese ofruese.
- f) Me dorëzimin e të dhënave, Pala Kontraktuese ofruese do të njoftojë Palën Kontraktuese pranuese për ndonjë afat kohorë për fshirjen e tyre sipas legjislacionit nacional të sajë. Pavarësisht kësaj, të dhënat duke iu referuar një individ të veçantë duhet të fshihen pa vonesë, kur ato nuk janë më të nevojshme. Pala Kontraktuese ofruese do të njoftohet për çdo fshirje të dhënave dhe arsyet për fshirjen e tyre. Me përfundimin e kësaj Marrëveshjeje të gjitha të dhënat e marra në bazë të saj do të asgjësohen.
- g) Palët kontraktuese do të mbajnë procesverbal për komunikim, pranim dhe fshirje të të dhënave personale. Procesverbali duhet të përfshijë informacion në lidhje me llojin, kohën dhe qëllimin e të dhënave të ofruara.
- h) Palët Kontraktuese do të marrin masat e duhura organizative dhe teknike për të mbrojtur të dhënat e marra personale nga çasja e paautorizuar, ndryshimin dhe publikimin.

#### Neni 5

- (1) Pas pranimit të kërkesës, secila Palë Kontraktuese mund të refuzojë atë, tërësisht ose pjesërisht, në qoftë se ajo nuk është në përputhje me legjislacionin nacional ose në qoftë se ajo kërcënon sovranitetin ose sigurinë kombëtare ose publike ose në përgjithësi shkel parimet e saj ligjore ose interesave të tjerë të rëndësishëm.
- (2) Pala Kontraktuese ofruese do të informohet sa më parë që është e mundur, për arsyet pse kërkesa nuk mund të përmbushet në tërësi ose pjesërisht.

#### Neni 6

Kjo Marrëveshje nuk do të ndikojë në asistencën ligjore ndërkombëtare për çështjet kriminale penale ose ekstradimet.

#### Neni 7

Secila Palë Kontraktuese do t'i bartë shpenzimet e bëra nga autoritetet e veta në zbatimin e kësaj Marrëveshjeje.

#### Neni 8

Palët Kontraktuese mund të bien dakord mbi protokollet për qëllime të zbatimit të kësaj marrëveshjeje.

#### Neni 9

Mosmarrëveshjet në lidhje me zbatimin e kësaj Marrëveshjeje që nuk mund të zgjidhen nëpërmjet konsultimeve ndërmjet autoriteteve kompetente të Palëve Kontraktuese do të zgjidhen nëpërmjet kanaleve diplomatike.

#### Neni 10

(1) Asgjë në këtë Marrëveshje nuk duhet të paragjykojë ndonjë marrëveshje tjetër dypalëshe ose shumëpalëshe të detyrueshme për Palët Kontraktuese

(2) Kjo Marrëveshje nuk do të paragjykojë ndonjë detyrim të Republikës së Sllovenisë që rrjedhin nga anëtarësimi i saj në Bashkimin Evropian.

## Neni 11


(1) Kjo marrëveshje hyn në fuqi në ditën e parë të muajit pasardhës pas pranimi të njoftimit të mëvonshëm me anë të cilit Palët Kontraktuese informojnë njëra tjetrën për përfundimin e procedurave të brendshme ligjore të nevojshme për hyrjen në fuqi.

(2) Kjo Marrëveshje do të lidhet për një kohë të pacaktuar. Secila Palë Kontraktuese mund ta shkëput atë me anë të një njoftimi me shkrim nëpërmjet kanaleve diplomatike. Marrëveshja do të pushojë së pasuri efekt gjashtë muaj pas ditës së parë të muajit që pason muajin në të cilin njoftimi i tillë është marrë nga Pala tjetër Kontraktuese.

Bërë në Lubjanë, më 12.05.2015 në dy kopje origjinale në gjuhën shqipe, serbe sllovene, dhe angleze, të gjitha tekset janë njëllëj autentike. Në rast të dallimeve në interpretim, do të mbizotërojë teksti në gjuhën angleze.

Për Qeverinë e Republikës

së Kosovës:



Për Qeverinë e Republikës

së Sllovenisë

